

Paskal MILO

UÇK në agjendën diplomatike të Shqipërisë në pranverë-verë të vitit 1998

Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK) si faktor ushtarak e politik ka historinë e saj për të cilën është folur e shkruar shumë. Ajo ka zhvilluar edhe diplomacinë e saj, në fillim në kushtet e ilegalitetit nëpër Evropë, por duke filluar nga pranvera e vonë e vitit 1998 edhe kontaktet e para publike përmes përfaqësuesve të saj në vende të ndryshme, por edhe në Kosovë.

Për t'i dalë përpara çdo keqkuptimi, termi diplomaci i përdorur në këtë rast ka karakter relativ dhe nënkupton kontakte me përfaqësues të vendeve e qeverive të ndryshme, jo zyrtare, informuese dhe sensibilizuese për gjendjen në Kosovë, për lirinë e të drejtat e shqiptarëve aty. Kjo është *faza e parë* e diplomacisë së UÇK. *Faza e dytë* e saj fillon pas majit-qershorit 1998, kur me iniciativën amerikane fillojnë kontaktet e para për të tërhequr UÇK-në në procesin e një negociate politike ndërshqiptare në Kosovë, për të krijuar një grup të përbashkët negociator, për të filluar bisedimet me Beogradin. Kjo fazë ka zgjatur deri në janar 1999. *Faza e tretë* e kësaj diplomacie, më e strukturuar dhe e organizuar, më intensive dhe me një platformë të qartë negociuese ishte Konferenca e Rambujesë dhe vijimi i saj në Paris në shkurt-mars 1999 dhe që shënoi një pikë sa kulmore aq edhe kthese në fatin e Kosovës e në luftën e UÇK për liri e pavarësi të saj. *Faza e katërt* u zhvillua në kushtet e luftës, mars-qershor 1999. Ajo u zbatua e tëra jashtë Kosovës, në Evropë e SHBA, me qeveri e në institucione,

konferenca e organizata ndërkombëtare. Ishte një kohë e paharrueshme e një shkollë e madhe për udhëheqësit e UÇK-së e për përfaqësuesit e saj që u përgatitën për të nesërmen e çlirimit, për drejtimin e vendit e për marrëdhëniet me jashtë të tij.

Qasja e diplomacisë së UÇK-së ishte revolucionare si vetë lufta e saj, shpesh edhe naive dhe e ndrojtur nga mungesa e përvojës, por edhe e kulturës së saj. Në Kosovë kishte edhe një diplomaci tjetër, ajo e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), e presidentit Ibrahim Rugova dhe e qeverisë së tij në emigracion. Ndonëse patën të njëjtin objektiv strategjik, pavarësinë e Kosovës, metoda e tyre diplomatike e veprimit ishte e ndryshme. LDK e kërkonte pavarësinë përmes metodës tradicionale pacifiste, përmes sensibilizimit të qeverive, organizmave ndërkombëtare dhe konferencave javore të shtypit në Prishtinë. LDK kishte njerëz më me përvojë, më shumë lidhje me kancelaritë evropiane dhe amerikane, instrumente e mjete financiare.

UÇK në fillim ishte e izoluar e nuk pranohej si aktor në bisedime, por ajo iu imponua tavolinave dhe kancelarive të diplomacisë ndërkombëtare. Jo me diplomatë të përgatitur dhe as me taktika diplomatike të stërholluara, por me diplomacinë e luftës në terren, në Drenicë e Dukagjin, në Llap, në Shalë e kudo tjetër që vepronin njësitë e armatosura të saj. Kjo metodë bëri që ajo të ftohej e të dëgjohej në tavolinat diplomatike edhe atje ku më parë nuk dëshironin dhe nga qeveri e njerëz që nuk e pëlqenin.

Çfarë thashë deri tani është një temë e një studim krahasues më veten, që do të mund të trajtohej më gjerë në një rast tjetër. Po kështu, koha nuk na lejon që të marrim në analizë të katër fazat e diplomacisë së UÇK-së, por do të përqendrohemi vetëm në fazën e parë të saj, në pranverë të vitit 1998. Dhe këtu nuk do të flasim për embrionet e

diplomacisë së UÇK-së, por për përfaqësimin në një mënyrë ose një tjetër të saj, nga diplomacia e shtetit shqiptar, që u bë natyrshëm zëdhënës i saj për sa e lejua koha e rrethanat.

UÇK nuk doli as brenda një muaji dhe as brenda një viti si një strukturë e mirorganizuar ushtarake dhe me një hierarki të zgjedhur qendrore. Ndaj edhe shfaqja e saj si një faktor ushtarak në Kosovë erdhi në rritje nga disa aksione lokale të shpërndara e të kryera nga grupe atdhetare kundër njësive policore dhe ushtarake serbe deri në krijimin e shtabit të përgjithshëm të saj. Këto aksione nuk tërhoqën vëmendjen e komunitetit ndërkombëtar, madje nuk u bënë të njohura aq shumë edhe në Shqipëri, ndonëse edhe dëshmorët e parë të UÇK-së, si: Zahir Pajaziti, Luan Haradinaj, Ardian Krasniqi e të tjerë, hynin e dilnin në vend, qëndronin në Tiranë, në Tropojë, Kukës e Has.

Shteti shqiptar në kohë e në mënyra të ndryshme, ka qenë strehë e mbështetje për luftëtarët shqiptarë kundër sundimit serb në Kosovë. Pa u zhytur thellë në histori, disa nga udhëheqësit e ardhshëm të UÇK-së e të strukturave aktuale të shtetit të pavarur të Kosovës që në vitet '80 të shekullit të kaluar, kanë qenë në kontakt me përfaqësitë diplomatike shqiptarë nëpër Evropë, por edhe me organe të specializuara të shtetit shqiptar, janë udhëzuar e kanë marrë mbështetje. Në fund të vitit 1990, udhëheqësi komunist Ramiz Alia ka pritur dhe ka biseduar me drejtuesit e Lëvizjes Popullore të Kosovës (LPK): Fazlli Veliu, Xhavit Haliti, Emrush Xhemajli, etj., ndërsa më 24 shkurt 1991 edhe kryetarin e LDK-së, Ibrahim Rugova.

Fillimi i shpërbërjes së Jugosllavisë i shtoi kontaktet ndërshtetërore mes dy anëve të kufirit dhe shumë shqiptarë nga Kosova, veçanërisht të rinj, erdhën në Shqipëri. Në gusht 1991, presidenti i Shqipërisë, Ramiz Alia, priti një grup deputetësh të Kuvendit të

Kosovës. Në dokumentin arkivor që reflekton këtë vizitë, është shënuar një deklaratë e tyre se “*po përpiqemi të tregohemi të matur në këtë situatë shumë të vështirë të krijuar, por jemi të përgatitur që dhunës do i përgjigjemi me dhunë*”.¹

Politika zyrtare njohu Republikën e Kosovës, presidentin e saj Ibrahim Rugova dhe Qeverinë në emigracion të Bujar Bukoshit. Po në këtë kohë, tetor-nëntor 1991, me urdhër të Ramiz Alisë, Ministria e Mbrojtjes dhe Komanda e Akademisë Ushtarake filluan stërvitjen luftarake të dy grupeve shqiptarësh nga Kosova në Surrel, njëri prej të cilëve kishte në krye Adem Jasharin dhe tjetri Zahir Pajazitin.² Pas ardhjes në pushtet të Partisë Demokratike, në prill 1992 e deri në vitin 1996 marrëdhëniet e LDK-së me Tiranën u intensifikuan dhe në protokollin e shtetit shqiptar. Presidenti i Kosovës dhe qeveria Bukoshi kishin një vend kryesor. Atyre iu ofruan mbështetje dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Qeverisë së Kosovës ku zyrat qendrore të saj i kishte në Tiranë. Po kështu edhe forcat e armatosura të Republikës së Kosovës (FARK) krijuan në Shqipëri baza logjistike e stërvitore.

Gjatë këtyre viteve në Shqipëri gjetën strehë e mbështetje edhe veprimtarë të tjerë shqiptarë nga Kosova, studentë e të rinj që hynin e dilnin ilegalisht prej saj ose me banim të përkohshëm në Zvicër, Gjermani, Austri etj., por që nuk kishin bindjet e LDK-së. Më tepër ishin anëtarë të Lëvizjes Popullore të Kosovës ose të bindjeve të majta në përgjithësi. Mes tyre në vitin 1993 Adem Jashari ka ardhur përsëri në Shqipëri.

¹Arkivi Qendror Shtetëror (AQSH), Fondi Nr. 489, Viti 1991, Dosja Nr. 155, f. 1-2.

² Hysen Ymeri, “... Stërvitëm dhe Adem Jasharin”, Tiranë, 2009, f. 6-7; Fehmi Pushkollli, *Zahir Pajaziti, Hero i Kombit*, Prishtinë, 2001, f. 192; 202-205.

Qëndrimi dhe veprimtaria e këtyre grupeve ra ndesh me filozofinë dhe politikën pacifiste të I. Rugovës e të LDK-së. Ata ishin për luftë të armatosur për çlirimin e Kosovës. Presidenti i Shqipërisë, Sali Berisha dhe Qeveria shqiptare, në vitet 1993-1997, duke mbështetur vetëm Ibrahim Rugovën dhe qasjen e tij të lëvizjes pacifiste në Kosovë, nuk i shihnin me sy të mirë aktivitetin e këtyre grupeve. Përmes shërbimeve sekrete të drejtuara nga Bashkim Gazidede u përdoqën dhe u vunë nën presion mjaftë anëtarë të LPK-së dhe disa, si: Zahir Pajaziti, Ardian Krasniqi, Hashim Thaçi etj., edhe u burgosën përkohësisht.³

Ngjarjet fatkeqe të pranverës së vitit 1997 dhe shpërthimi i depove të armëve të ushtrisë shqiptare, solli ndër shumë e shumë të këqija edhe një mundësi për grupet revolucionare të Kosovës për t'u armatosur. Në kushtet e një rënie thuajse të plotë të shtetit e të një anarkie të pashembullt, shqiptarët nga Kosova grumbulluan sasi të mëdha armatimi dhe krijuan baza logjistike në veri të vendit nga ku pastaj futeshin armët në Kosovë. Kështu u zgjeruan dhe u armatosën grupe të reja luftarake me emblemën e UÇK-së në Kosovë.

Ardhja në pushtet e qeverisë së koalicionit të majtë pas zgjedhjeve të qershorit 1997, në Tiranë u prit mirë nga grupet revolucionare të armatosura të UÇK-së në Kosovë dhe po kështu nga udhëheqja politike e LPK-së dhe organizatave të tjera të majta. Përfaqësues të tyre tentuan në fund të nëntorit 1997 që të takoheshin me kryeministrin Fatos Nano, por nuk iu arrit qëllimit. Kjo tentativë përkoj edhe me daljen e parë publike të përfaqësuesve të UÇK-së në Kosovë. Si përfundim, mund të thuhet se deri në fundin e vitit 1997

³ Bedri Islami, "Shansi i fundit në fillim të shekullit", *Epoka e re*, Prishtinë, 2003, f. 25.

nuk ka pasur asnjë kontakt zyrtar të nivelit të lartë në Tiranë mes qeverisë shqiptare dhe strukturave të veçanta ushtarake apo politike që u shfaqën me emblemën e UÇK-së. Por, ka pasur takime jo zyrtare e bashkëpunim të fshehtë mbi baza njohjeje personale me funksionarë të lartë në Tiranë, në Ministrinë e Mbrojtjes e në atë të rendit, e padyshim me drejtues të shërbimeve sekrete shqiptare. Përmes tyre u garantuan në përgjithësi furnizimet me armatim e municione për në Kosovë.⁴

Shfaqja e UÇK-së dhe rritja e aksioneve të saj luftarake në dhjetor 1997 e fillimi i janarit 1998, rrezikuan prishjen e një lloj status quo-je që ishte vendosur në Kosovë midis kërkesave paqësore të Rugovës dhe regjimit policor të Millosheviqit. Por, aktiviteti luftarak i UÇK-së kërcënoi të nxirrte jashtë loje e të bënte të pavlerë edhe strategjinë e Grupit të Kontaktit (Britania e Madhe, Franca, Gjermania, Italia e Rusia) të miratuar më 24 shtator 1997, në Nju Jork, për të nxitur bisedimet mes Rugovës e Millosheviqit qoftë edhe me ndërmjetës ndërkombëtarë, në kërkim të përmirësimit të statusit të Kosovës drejt një autonomie në fushën e lirive e të drejtave të njeriut, zhvillimit të arsimit e kulturës kombëtare.

Shtetet e Bashkuara dhe pesë vendet e tjera anëtare të Grupit të Kontaktit e kishin bërë të qartë dhe këtë mesazh, ia kishin përcjellë edhe Qeverisë shqiptare se statusi i ardhshëm i Kosovës nuk do të ishte as më shumë e as më pak veçse një autonomi e zgjeruar në kufijtë e asaj që kishte ekzistuar në Kushtetutën e RFJ të vitit 1974. Gjithashtu, qeveritë e këtyre vendeve njihnin e vlerësonin si udhëheqës politik të shqiptarëve të Kosovës vetëm Ibrahim Rugovën dhe mbështetnin lëvizjen e tij pacifiste. Këtë qëndrim Sekretarja amerikane e Shtetit,

⁴ Intervistë e ish-zëvendësministrit të Rendit Publik, Sokol Baraj. Rajmonda Maleçka, *Hasi mes luftës dhe lirisë*, Shtëpia Botuese: “Weso”, f. 93-95.

Madelene Ollbrajt, ia bëri të ditur Fatos Nanos që në takimin e parë në Nju Jork, në shtator 1997, kur deklaroi se: “*Ne mendojmë se Rugova është një udhëheqës i dobishëm*” dhe se “*Kosova duhet të ketë autonomi të gjerë, por jo pavarësi*”.⁵Këto vlerësime nga shtatori i vitit 1997 e deri në mars të vitit 1998, iu përcollën Qeverisë shqiptare nga të gjithë ministrat e jashtëm të qeverive të vendeve të Grupit të Kontaktit.

Deri në nëntor 1997, UÇK-ja apo alternativa radikale e shqiptarëve të Kosovës për të arritur pavarësinë e saj nuk ekzistonte në agjendën diplomatike të Uashingtonit dhe jo më në ato të qeverive të vendeve të tjera të Grupit të Kontaktit, që ishin të prirura në mënyrë të përshkallëzuar të shihnin një formulë më të thjeshtë zgjidhjeje në krahasim me atë amerikane. Ndaj edhe reagimet e para të qeverive të vendeve anëtare të Grupit të Kontaktit ishin kundërshtuese.

Ambasadori Robert Gelbard, përfaqësuesi i posaçëm i presidentit të SHBA-së, Bill Klinton dhe i Sekretares së Departamentit të Shtetit, Madelen Ollbrajt, për zbatimin e marrëveshjeve të paqes të Dejtonit për Bosnjë-Hercegovinën, më 6 janar 1998, në një konferencë shtypi dha vlerësimin dhe paralajmërimin e parë publik për UÇK-në. Është një grup tha ai, “*i cili duhet të jetë shumë i kujdesshëm në çfarë bën dhe çfarë kërkon të bëjë. Ajo po merr mbi vete rrezikun e të etiketuarit organizatë terroriste nga qeveria e SHBA-së*”.⁶Një muaj më vonë, ministri i Jashtëm i Gjermanisë, Klaus Kinkel, në vizitën e tij në Tiranë, ndërsa deklaroi se “*Kosova nuk është çështje e brendshme e*

⁵ Paskal Milo, *Ditari i një ministri të Jashtëm. Konflikti i Kosovës (1997-2001)*, Botimet Toena, Tiranë, 2009, f. 18.

⁶Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë (AMPJ), Informacion: Robert Gelbard dhe Kosova, Mars 1998, Deklaratë, 6 janar 1998.

Jugosllavisë”, pohoi gjithashtu se “*pavarësinë e Kosovës nuk e mbështesim*” dhe “*as nuk e përkrahim lëvizjen separatiste*”.⁷

Përballë këtyre paralajmërimeve amerikane dhe evropiane e në situatën e brendshme politike të vendit ende të pastabilizuar, qeveria shqiptare u ndodh në dilemën e orientimit. Ajo nuk kishte zyrtarisht asnjë kontakt me strukturat e UÇK-së e asnjë njohje të drejtuesve të saj, por

vetëm njohje periferike të përfaqësuesve të veçantë të LPK-së në emigracion që qëndronin në Tiranë ose që vinin herë pas here aty. Për të mësuar diçka konkrete e për të krijuar një kontakt, në fund të shkurtit, ministri i Jashtëm shqiptar, duke shfrytëzuar një vizitë në Mynih, u takua në mënyrë jo publike e në orët e vona të natës me një grup përfaqësuesish të LPK-së, njëkohësisht edhe të UÇK-së. Kryesorët ishin: Bedri Islami, Fehmi e Ramiz Lladrovc i dhe Rexhë Ibërdemaj.⁸

Sekreti në të cilin u organizua ky takim nuk ishte thjesht për arsye të sigurisë personale të përfaqësuesve të rëndësishëm të LPK-UÇK-së, por edhe të moskomprometimit të ministrit të Jashtëm e të Qeverisë shqiptare në raportet sidomos me Qeverinë amerikane që këshillonte distancim, siç i cilësonte ajo, nga ekstremistët e terroristët shqiptarë. Katër-pesë ditë më parë, Gelbard pas takimit me Millosheviqin në Beograd, e në vijim të aksioneve të UÇK-së, sidomos në Drenicë, bëri deklaratën më të ashpër kundër saj. Ai tha në qendër të Beogradit se “*ne dënojmë shumë fort veprimet terroriste në Kosovë. UÇK është pa dyshim një grup terrorist*”.⁹Nëse deklarimi i parë i tij në

⁷ Paskal Milo, *Ditari i një ministri të Jashtëm...* f. 32.

⁸ Bedri Islami, *I vërteti (Ali Ahmeti)*, Shtëpia Botuese: Tringa Desing, Tetovë, 2011, f. 40-41.

⁹ Wolfgang Petritsch, Robert Pichler, *Rruga e gjatë në luftë. Kosova dhe bashkësia ndërkombëtare 1989-1999*, Koha, Prishtinë, 2002, f. 92.

janar në Uashington ishte paralajmërues e kërcënues, deklarata e Beogradit shënoi një cilësim të plotë zyrtar amerikan ndaj UÇK-së.

Në këto rrethana u zhvillua takimi në Mynih. Aty ministri i Jashtëm shqiptar u njoftua për ekzistencën e UÇK-së dhe për vendosmërinë e saj për ta çuar deri në fund luftën e armatosur. Ata kërkuan më shumë mbështetje politike nga Qeveria shqiptare si dhe furnizime me armë. Fehmi Lladrovci që më la mbresën e Çe Guevarës të Kosovës, ishte shumë i informuar se çfarë pritej, sepse, në përfundim të bisedës ai lëshoi frazën se *“keni për të parë se çfarë ka për të ndodhur së shpejti në Kosovë”*.¹⁰

Ajo çfarë ai paralajmëroi duke u gdhirë 28 shkurti ndodhi po atë ditë. Sllobodan Millosheviqi deklaratën e Gelbardit në Beograd, më 23 shkurt, e interpretoi si dritë jeshile dhe si inkurajim për të sulmuar bazat e UÇK-së në Drenicë e për t'i eliminuar ato. Forcat e policisë speciale e të ushtrisë serbe shpërthyen një ofensivë të madhe e të egër kundër Drenicës duke vrarë e masakruar dhjetëra njerëz civilë, gra, fëmijë, pleq e mes tyre edhe luftëtarë të UÇK-së me në krye, Adem Jasharin.

Ngjarja ishte e jashtëzakonshme jo vetëm nga përmasat e krimit, por edhe për rrjedhojat që solli e jehonën që pati. Qeveria shqiptare dhe të gjitha institucionet e tjera të shtetit shqiptar reagueshan fuqishëm duke reflektuar ndjenjat mbarëkombëtare të shqiptarëve në Shqipëri e jashtë saj. Qeveria shqiptare bëri një deklaratë zyrtare ku dënohej me terma shumë të forta ofensiva ushtarake serbe në Drenicë dhe ku i bëhej thirrje komunitetit ndërkombëtar për ndërhyrje. U dërguan letra ministrave të jashtëm të Grupit të Kontaktit, Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, u kërkuua mbledhja e Këshillit të Sigurimit dhe bënë konsultime me NATO-n në Bruksel.

¹⁰ Paskal Milo, *Ditari i një ministri të Jashtëm...* f. 34.

Komuniteti ndërkombëtar reagoi menjëherë, por në mënyrë disproporcionale për të përcaktuar përgjegjësit për ngjarjet dramatike të Drenicës. Shtetet e Bashkuara, Britania e Madhe, Gjermania e Franca nënvizuan si shkaktar kryesor regjimin e Millosheviqit pa anashkaluar edhe gjykimin për veprimtarinë e UÇK-së. Rusia ndërkohë në traditën e qëndrimeve të saj, mori pozitën në mbrojtje të Serbisë duke akuzuar UÇK-në si forcë terroriste, por edhe duke folur me gjysmëzëri për nevojën e një autonomie më të gjerë për shqiptarët e Kosovës. Italia lëkundej diku në mes dhe sugjeronte si formulë për zgjidhje statusin e provincës së Alto-Adige-s (Tirolit Jugor).

Ngjarjet e Drenicës e rikapituluuan më me intensitet temën e natyrës së UÇK-së e të qëndrimit ndaj saj, por edhe të statusit që duhej të kishte Kosova. Qeveria shqiptare në rrethanat e reja nuk mund të qëndronte në heshtje, por bëri një ndryshim cilësor *duke e konsideruar luftën e UÇK-së si akt vetëmbrojtjeje pasi ishte humbur shpresa për të gjetur një zgjidhje paqësore*.¹¹

Shqipëria u vendos në një vëmendje prioritare nga komuniteti ndërkombëtar për disa arsye, por më kryesorja për të shmangur kthimin e saj në bazë e prapavijë të UÇK-së që mund të çonte në një konflikt të gjerë shqiptaro-serb me rrjedhoja të paparashikuara për gjithë rajonin. Stabiliteti i brendshëm i Shqipërisë ishte gjithashtu një arsye ndaj edhe ajo lipsej që të ndihmohej.

Këshillat dhe paralajmërimet ndaj Qeverisë shqiptare vërshuan nga të gjitha anët. Në kulmin e ngjarjeve të Drenicës, më 2 mars, Uashingtoni i dërgoi Tiranës mesazhin se “*Qeveria shqiptare duhet të qëndrojë sa më larg UÇK-së, të mos ketë dhe të refuzojë çfarëdo lloj*

¹¹AMPJ, Informacion i Ambasadës shqiptare në Paris dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Tiranë, 6 mars 1998.

kontakti me të, duke e injoruar plotësisht".¹²Mesazhi tjetër që pasoi ishte që Qeveria shqiptare të merrte të gjitha masat e duhura për të parandaluar civilët e armatosur nga Shqipëria për të hyrë në Kosovë, për të përdorur të gjitha kanalet e saj për të influencuar ndër shqiptarët e Kosovës që ndodheshin në Zvicër apo gjetkë, që të mos ndërmerrnin veprime të tilla e të mos grumbulloheshin mjete financiare për të përkrahur UÇK-në.¹³Të tilla mesazhe erdhën në Tiranë edhe nga kryeqytetet e tjera të vendeve të Grupit të Kontaktit, përfshirë edhe Moskën e cila fliste me tone të theksuara proserbe. Madje Rusia, në vijim të akuzave serbe, shpërndau dyshime se në veri të Shqipërisë ekzistonin kampe të stërvitjes së UÇK-së.¹⁴Kjo akuzë u përcoll edhe në zyrat e OSBE-së në Vjenë, e cila kërkoi sqarime në Tiranë.¹⁵

Ngjarjet e Drenicës i dhanë UÇK-së peshë dhe dimension tjetër. Ato imponuan në Uashington e në Evropë një qasje më serioze e më konkrete në kërkim të një zgjidhjeje. Deklarata e 9 marsit e Grupit të Kontaktit, dënoi aksionin e gjerë policor serb "*që nxitën edhe më shumë situatën në shpërthim*". U kërkua vendosja e embargos së armatimit ndaj RFJ-së duke përfshirë edhe Kosovën, tërheqjen e të gjitha forcave speciale policore serbe dhe ndërprerjen e veprimeve të forcave të sigurimit në Kosovë, fillimin e procesit të dialogut të Beogradit me udhëheqjen e komunitetit shqiptar në Prishtinë, kthimin

¹²AMPJ, Informacion i Ambasadës shqiptare në Uashington për Ministrinë e Punëve të Jashtme në Tiranë, 2 mars 1998.

¹³AMPJ, Informacion i Ambasadës shqiptare në Uashington për Ministrinë e Punëve të Jashtme në Tiranë, 6 mars 1998.

¹⁴AMPJ, Komunikim gojor i ambasadorit të Rusisë në Tiranë, Saprikin, në Ministrinë e Punëve të Jashtme në Tiranë, 6 mars 1998.

¹⁵Ditar i ministrit të Jashtëm, Paskal Milo (i pabotuar). Takim me ambasadorin e OSBE-së në Tiranë, Dan Everts, 6 mars 1998.

e misionit afatgjatë të OSBE-së në Kosovë si dhe nisja e një misioni të ri të ish-kryeministrit të Portugalisë, Felipe Gonzales, si përfaqësues personal i kryetarit të radhës së OSBE, etj.¹⁶ Teksti dhe fryma e masave të propozuara kishte karakterin e ultimatumit dhe Milosheviqit iu la dhjetë ditë kohë për të reflektuar e vepruar. Në rast të kundërt kërcënohej me kalimin në fazën e dytë të sanksioneve kundër RF të Jugosllavisë.

Deklarata e Grupit të Kontaktit ishte dokumenti më i ashpër adresuar Beogradit pas nënshkrimit të marrëveshjes të Dejtonit në përfundim të luftës në Bosnjë-Hercegovinë. Por, hartuesit e Deklaratës u kujdesën që për shkak të ekuilibrave të brishta brenda Grupit të Kontaktit e sidomos për të mbajtur Rusinë në proces, për shkak të mospajtimeve të tyre me frymën revolucionare të luftës së UÇK-së, të hartonin një dokument të balancuar. Ndaj edhe në Deklaratë gjetën vend edhe frazat se dënimi i veprimeve të policisë serbe *“nuk duhet të merret në asnjë rast si përkrahje ndaj terrorizmit, nga ana tjetër... Ne dënojmë tërësisht veprimet terroriste nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës... Ne këmbëngulim në të njëjtën kohë që të ndërpritet menjëherë çdo mbështetje financiare, me armatim apo përgatitje për aktivitetet terroriste nga jashtë RFJ”*.¹⁷

Deklarata përfundonte me nënvizimin e qëndrimit të unifikuar të komunitetit ndërkombëtar për thelbin e konfliktit shqiptaro-serb e të ardhmen e Kosovës. Shprehimisht aty thuhej se *“ne nuk mbështesim as*

¹⁶AMPJ, Viti 1998, Deklarata për Kosovën në takimin e Grupit të Kontaktit, Londër, 9 mars 1998.

¹⁷Po aty.

*pavarësinë as gjendjen e status quo-së... Ne mbështesim një status të avancuar për Kosovën brenda RFJ... ”.*¹⁸

Në dritën e zhvillimeve dramatike në Kosovë e të Deklaratës së Grupit të Kontaktit, Tirana u kthye në një qytet “pelegrinazhi diplomatik”. Zyrtarë e diplomatë të nivelit të lartë, ministra e ushtarakë të NATO-s vizituan kryeqytetin shqiptar. Më 12 mars, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Javier Solana, i shoqëruar nga komandanti suprem i Forcave Aleate në Evropë, Wesli Clark, erdhi në Tiranë. Një vizitë që qartazi dëshmoi interesimin e NATO-s për krizën në Kosovë e për rreziqet që e shoqëronin atë si dhe mbështetje e siguri të tij për Shqipërinë. Veçse, Solana shprehu shqetësim për nivelin e kontrollit të kufijve shtetërorë dhe përshkueshmërinë e tyre.¹⁹

Diplomacia shëtitëse e SHBA-së dy herë brenda muajve mars-prill, risolli me porosi të presidentit Klinton e Sekretares së Shtetit, Ollbrajt, Strobe Talbott e Robert Gelbard, në Tiranë. Kërkesat e tyre ndaj Qeverisë shqiptare ishin bashkëpunim për të frenuar radikalizimin e situatës dhe ekstremizmin në Kosovë, mos furnizim të strukturave të UÇK-së me armë e municione nga depot e ushtrisë shqiptare, si dhe paralajmërimin e tyre se mbështetja amerikane për pavarësinë e Kosovës ishte zero.²⁰

Këmbëngulja amerikane e vuri në pozitë delikate qeverinë shqiptare. Nga njëra anë duhej të respektohej kërkesa e SHBA-së si vend mik e partner strategjik i Shqipërisë, por nga ana tjetër nuk mund

¹⁸*Po aty.*

¹⁹*AMPJ*, Informacion për vizitën e Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, Javier Solana, Tiranë, 12 mars 1998.

²⁰*AMPJ*, Informacione mbi vizitën e zëvendëssekretarit amerikan të Shtetit, Strobe Talbott, në Tiranë, 16 mars e 18 prill 1998; Informacion mbi vizitën e Robert Gelbard, në Tiranë, 18 mars 1998.

të mos mbështeteshin shqiptarët kryengritës të Kosovës në luftën e tyre kundër zgjedhës serbe. Për të dalë nga kjo pozitë “sandwich”, në Tiranë u bë një ndarje detyrash: Qeveria shqiptare dhe diplomacia e saj do të qëndronin në mbështetje të luftës së shqiptarëve si akt vetëmbrojtjeje kundër politikës e dhunës shfarosëse të regjimit të Millosheviqit, por edhe do të sinkronizoheshin me qëndrimet amerikane, britanike e më pak me ato të Grupit të Kontaktit në tërësi. Nëse Qeveria shqiptare hezitoi përsëri të takonte në nivel të lartë një grup përfaqësuesish të LPK-UÇK-së, ajo lejoi nga ana tjetër që shërbimi sekret shtetëror shqiptar dhe struktura të posaçme të ushtrisë shqiptare, në heshtje të koordinonin ndihmën dhe mbështetjen për UÇK-në.

Ky qëndrim i dyzuar i Qeverisë shqiptare nuk mbeti pa u vënë re nga Departamenti i Shtetit. Riçard Hollbruk, “buldozeri” i diplomacisë amerikane, negociatori i Dejtonit, i sapo emëruar si ambasador i SHBA-së në OKB, morri përsipër një projekt që do të synonte të realizonte një Dejton të ri për Kosovën, por në kuadër të Jugosllavisë. Misioni i tij ishte të ulte në tavolinën e negocimit, Millosheviqin me Ibrahim Rugovën. Për këtë qëllim në maj 1998 ndërmori një turne që e çoi në fillim në Tiranë e pastaj në Prishtinë e Beograd.

Qeveria shqiptare, kur Hollbruk, më 10-11 maj, erdhi në Tiranë, i shoqëruar nga Gelbard, Swigert, Kristofer Hill, ambasador i SHBA-së në Shkup, nuk e dinte se ai do të shkonte në Beograd e në Prishtinë. As edhe Hollbruku nuk i njoftoi. Ai nuk donte në ato momente që Qeveria shqiptare me deklaratat e qëndrimet e saj t’u ngatërronin amerikanëve letrat e lojës që ishin duke luajtur. Në qëndrimin e Hollbrukut u ndjenë shenja të lehta qortimi e presioni ndaj

Qeverisë shqiptare që në disa raste kishte bërë deklarata e kishte toleruar veprime në mbështetje të UÇK-së.

Vërejtjet e përfaqësisë së lartë diplomatike amerikane se nga Shqipëria vazhdonte trafiku i armëve, i njerëzve dhe i parave, u shoqëruan me kritika për Qeverinë shqiptare, se kjo dobësonte pozitën e Rugovës. Hollbruku u tha padrejtësisht bashkëbiseduesve të tij shqiptarë se *“ju nuk po bëni asgjë për ta ndihmuar atë”*.²¹ Amerikanët donin të dinin burimin e trafikut të armëve, i shqetësonte mundësia e ngritjes së kampeve të rezistencës nga ana e UÇK-së në Shqipëri, ndërhyrja e grupeve islamike dhe ardhja e muxhahedinëve. Nëse vërtetoheshin këto fakte, paralajmëruan ata, do të komplikohesh shumë çështja e reagimit ndërkombëtar, do të ndryshonte çdo gjë në marrëdhëniet e SHBA-së me Shqipërinë si dhe pozicioni evropian.²²

Qeveria shqiptare nuk i pranoi kritikën e Hollbrukut. Madje edhe mbeti disi e zhgënjyer prej tij. Por, vetëm katër ditë më vonë, ajo e kuptoi thelbin e kritikave të tij kur, më 15 maj u njoftua takimi në Beograd i Sllobodan Milosheviqit me Ibrahim Rugovën. Për këtë takim, Ibrahim Rugova në shoqërinë e Bujar Bukoshit, Fehmi Aganit e Veton Surroit u shpërblye më 29 maj me një pritje në Uashington nga presidenti Klinton e Sekretarja e Shtetit, Ollbrajt.

Administrata amerikane u investua shumë për Rugovën dhe pas tyre edhe qeveritë e vendeve anëtare të BE-së. Ajo shpeshoi se me këtë mbështetje të gjerë do të rriteshin kredencialet e tij politike në rënie para shqiptarëve dhe do të pranohej edhe nga UÇK-ja si udhëheqës politik i saj. Madje edhe Rugova e pretendoi këtë rol në mënyrë

²¹AMPJ, Viti 1998, Informacion për vizitën e Riçard Hollbrukut, në Tiranë, 10-11 maj 1998.

²²AMPJ, Informacion për vizitën e Riçard Hollbrukut, në Tiranë, 10-11 maj 1998.

publike. Uashingtoni gaboi në këto llogari. UÇK-ja e hodhi poshtë këtë pretendim dhe së bashku me faktorët e tjerë politikë në Kosovë e kritikoi ashpër takimin Millosheviq-Rugova, në Beograd.

Në këto rrethana, SHBA bënë një rishikim të politikës së tyre ndaj Kosovës. Ajo e kuptoi mirë se UÇK nuk ishte një grup nacionalistësh radikalë shqiptarë që i kishin hyrë një aventure të dhunshme, por një lëvizje që po rritej dita-ditës e që po gjente mbështetje të gjerë nga shqiptarët brenda dhe jashtë Kosovës. Ajo po bëhej një realitet politik dhe ushtarak i paneglizhueshëm në të gjitha kombinacionet e mundshme të një zgjidhjeje për çështjen e Kosovës. Në Uashington u vendos që në sekret të plotë të vendosej kontakti i parë me UÇK-në. Terrenin e përgatit K. Hill së bashku me strukturat e posaçme amerikane në rajon.

Më 23 qershor, Riçard Hollbruk, në kuadrin e një turneu rajonal e në shoqërinë e Gelbard e Hill, mori takim me dy përfaqësues lokalë të UÇK-së në zonën e Drenicës. Të nesërmen, Departamenti i Shtetit deklaroi se nuk e konsideronte UÇK-në si terroriste. Kjo kthesë e beftë amerikane e pakonsultuar me qeveritë e vendeve anëtare të BE-së, ngjalli nervozizëm e kundërshtime. Amerikanët u shpjeguan se synimi i tyre ishte që në kushtet e një realiteti të dukshëm, UÇK të vendosej nën kontrollin politik dhe të përfshihej në bisedime. Formula e përfshirjes do të ishte krijimi i një këshilli ose autoriteti koordinues nga të gjithë faktorët politikë e ushtarakë shqiptarë të Kosovës. Kjo strategji ishte biseduar me Rugovën në Uashington dhe ishte marrë pëlqimi i tij. Misionin për të udhëhequr punën në terren për krijimin e këtij këshilli dhe për hartimin e një platforme bisedimesh me regjimin e Millosheviqit e morri përsipër Kristofer Hill.

Qasja e re amerikane ndaj UÇK-së u prit mirë në Tiranë. Ajo i dha frymëmarrje edhe qëndrimit të Qeverisë shqiptare ndaj UÇK-së, në njëfarë mënyre gjysmëzyrtarizoi marrëdhëniet me të. Amerikanët i qartësuan Qeverisë shqiptare synimet e tyre për të bërë *“përpjekje për vendosjen e UÇK-së nën kontroll politik”*, se ajo *“duhet marrë në konsideratë si realitet, sepse është zgjeruar”*. Por, duke theksuar se *“ne kemi vendosur të mbajmë konfidenciale rezultatet etakimeve tona me UÇK-në”*, ata paralajmëruan përsëri *“se pika fokale është dr. Rugova”*.²³ Madje në gusht 1998, u duk sikur u tërhoqën përsëri kur mesazhet e përcjella nga Departamenti i Shtetit në Ministrinë e Jashtme shqiptare, nënvizonin se: *“pala amerikane është e prerë në opozitën e saj ndaj veprimtarisë së UÇK-së duke e konsideruar atë të pashpresë”*, se *“ne nuk e mbështesim UÇK-në. Ne kemi qenë gjithnjë të mendimit se situata në Kosovë nuk mund të zgjidhet ushtarakisht”*. Departamenti i Shtetit vazhdonte t’i kërkonte Qeverisë shqiptare edhe në gusht 1998 *“ndalimin e trafikut të armëve nga jugu i Shqipërisë drejt Veriut e më tej në Kosovë”*, pasi *“mund të ndikojë në përpjekjet tona për zgjidhjen diplomatike në Kosovë”*.²⁴

Në Tiranë ishin në dijeni të përpjekjeve amerikane për të krijuar një këshill koordinues shqiptar me pjesëmarrjen edhe të UÇK-së, por që të ishte nën kryesinë e Rugovës. Megjithatë, Qeveria shqiptare tashmë ishte e bindur për të mos dëgjuar gjithçka që i servirej. Kishte ardhur koha që ajo të shfaqej hapur në vendosjen e kontakteve me UÇK-në. Në fillim të muajit korrik, krerët më të lartë të shtetit shqiptar,

²³ Informacione të Ambasadës shqiptare në Uashington për Ministrinë e Jashtme në Tiranë, 29 qershor 1998; 10 korrik 1998.

²⁴ AMPJ, Informacion mbi vizitën e drejtorit të Evropës Juglindore të Departamentit të Shtetit L. Rossin, në Tiranë, 3 gusht 1998.

presidenti Rexhep Meidani dhe kryeministri Fatos Nano, veç e veç pritën në takime disa drejtues të LPK-së dhe anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së.²⁵

Njohja e pjesshme e realitetit të UÇK-së nga ana amerikane dhe drita gjysmëjeshile që administrata e Uashingtonit i hapi Qeverisë shqiptare në marrëdhëniet me UÇK-në, shënoi një fazë të re bashkëpunimi trekëndor, jo publik, me ulje-ngritje, me elemente mosbesimi të ndërsjellët në funksion të objektivave të gjithsecilit. Ky bashkëpunim e mirëkuptim minimal do të vijë në rritje me gjithë kthesat nganjëherë edhe prapa për të arritur një trajektore të pakthyeshme pas Konferencës së Rambujesë e ndërhyrjes së NATO-s, që çoi në çlirimin historik të Kosovës në qershor 1999.

²⁵ Bedri Islami, *I vërteti(Ali Ahmeti)*..., f. 41-44.